



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 2025/0004

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi – Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE Ari med L.L.C. kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-se” me numër të prokurimit: 623-24-11352-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna - Rahovecë”, me datën: 03/03/2025, mori këtë:

V E N D I M

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e Ari med L.L.C. me nr. të protokollit 2025/0004, e datës 02/01/2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-se”, me numër të prokurimit: 623-24-11352-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna - Rahovecë”.

2. I lejohet, autoritetit kontraktues – “Komuna - Rahovecë” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-se”, me numër të prokurimit: 623-24-11352-1-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.10.2024, "Komuna - Rahovecë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-se" me numër të prokurimit: 623-24-11352-1-1-1 Ndërsa me datën 19.12.2024 AK ka publikuar B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues për shpërbllim me kontratë. **Lot 2** GOE Brt Pharm SH.P.K.&NeraMed N.SH.T.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 305,830.00€, ndërsa për LOT 2, për të cilin është paraqitur edhe ankesa ka vlerë të parashikuar prej 131,919.00€

Me 23.12.2024 OE "Ari med L.L.C." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK për LOT 2. Me 24.12.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.01.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Ari med L.L.C." me nr. 2025/0004 lidhur me aktivitetin "Furnizim me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-se" me numër të prokurimit: 623-24-11352-1-1-1 për LOT 2.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Ari med L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Ne nuk pajtohemi me asnjë nga arsyetimet e ofruara nga Autoriteti Kontraktues (AK) në kërkesën për rishqyrtim që kemi dorëzuar.

Pretendimet tona janë të bazuara në fakte konkrete, të cilat AK nuk i ka marrë parasysh. Kërkesa jonë është që kjo procedurë të anulohet dhe të ripublikohet, pasi Operatorët Ekonomikë (OE) të rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë kushtet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dokumentet që janë kërkuar nga AK në Ftesën për Dërgim të Tenderëve (FDT).

Pika 1 e ankesës:

Grupi i OE BRT Pharma SHPK dhe NSHT Neramed nuk kanë dorëzuar deklaratat që kërkohen nga AK sipas FDT, specifikacionit teknik, Neni 3.1 i FDT dhe kushtet e dërgimit - deklarata për afatin e dorëzimit, Neni 5.2 i FDT. Këto dy deklarata janë të detyrueshme nga AK.

Pika 2 e ankesës:

Grupi i OE BRT Pharma SHPK dhe NSHT Neramed nuk kanë autorizim nga prodhuesi Beckman Coulter për artikujt 65, 66 dhe 67. Asnjë kompani tjetër nuk mund të prodhojë reagjentë për TSH, T4 dhe T3 për pajisjen që është në pronësi të QKMF-së në Rahovec. Pretendimet e AK dhe OE i rekomanduar për kontratë se prodhuesi GESAN mund të prodhojë reagjentë për këtë pajisje janë të pavërteta dhe mashtruese. OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur kontratën e GESAN si autorizim nga prodhuesi, e cila është një kontratë mbi 30 faqe që nuk dëshmon asgjë përveç marrëveshjeve konfidenciale midis prodhuesit GESAN dhe kompanisë Genius Kosova. Kjo kontratë nuk ka lidhje me dokumentacionin që kërkohet për artikujt 65, 66 dhe 67.

Po ashtu, AK ka refuzuar autorizimin që kemi paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar AtomMed O.P, duke pretenduar se ky OE është në Listën e Zezë, dhe për këtë arsye, autorizimi në këtë rast nuk ka vlefshmëri. Ky veprim përbën shkelje të procedurave dhe diskriminim ndaj nesh si OE, pasi Lista e Zezë ndalon vetëm pjesëmarrjen në tendera publikë dhe nuk ndalon dhënien e autorizimeve për OE si distributor të autorizuar, sipas kërkesës së bërë në Formularin Standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54.

Bazuar në faktet dhe argumentet që kemi paraqitur, kërkojmë që kjo procedurë të anulohet.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se: 263,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë bankë e licencuar në Kosovë.

Sqarimi:

Në ofertën tuaj të dorëzuar, keni prezantuar një Raport Bankar nga NLB Bank, ku pasqyrohet që qarkullimi i juaj është në vlerë prej: 221,639.60 €, ndërsa sipas Njoftimit për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), për Lot II është kërkuar në vlerë jo më pak se: 263,000.00 €.

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, kemi shembullin se si duhet vepruar:

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale. Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm.

Andaj, oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

2. Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. LOT II 197,500.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Lista e furnizimeve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e furnizimeve të ngjashme, të realizuara në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operator Ekonomik, dhe dëshmitë e përfundimit, referencat dhe procesverbali i pranimi të furnizimeve.

Sqarimi:

Referenca/t ose procesverbali/et e pranimi të furnizimeve, në lëmin e furnizimeve të ngjashme, të prezantuara nga juaj, janë në vlerë prej: 19,980.00 €, ndërsa sipas Njoftimit për Kontratë dhe sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), për Lot II është kërkuar në vlerë jo më pak se: 197,500.00 €.

Po ashtu, në ofertën tuaj të dorëzuar, keni prezantuar referencat me subjekte, por nuk i keni bashkangjitur dëshmitë, të specifikuar tek Dëshmia Nr. 1 të Kapacitetit teknik dhe profesional, ku thotë: "Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, ato duhet të prezantojnë transaksionin bankar që përputhet me të njëjtën kontratë - Referencë."

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, kemi shembullin se si duhet vepruar:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar. Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm.

Andaj, oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/01/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0004/25, ndërsa me datë 27/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0004 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertin shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hudhet poshte si e pa lejuar, ndërsa vendimi i AK-se të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Ari med L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0004 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues Ari med L.L.C., i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues/ Komuna ne Rahovec, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), konkretisht pretendon se i rekomanduari për kontrate është i papërgjegjshëm dhe ne fund te ankesës se tij kërkon anulimin ne tërësi te aktivitetit te prokurimit. Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit fillestar te ankesës se OE ankues, ka vërejtur se OE ankues, ka pretendime ankimore lidhur me kualifikimin e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate për te cilin pretendon se është i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, sqaron se sa u përket arsyeve te eliminimit, OE ankues nuk ka dhënë asnjë argument se i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit, por ne ankesën e tij vetëm pretendon se i rekomanduari për kontrate është i papërgjegjshëm dhe ne fund kërkon anulimin ne tërësi te këtij aktiviteti te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se fakti qe OE ankues nuk ka arritur te jep fakte dhe argumente se i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe potencialisht mund te jetë nënshkruar i kësaj kontrate publike, atëherë rezulton qe ky operatore ekonomik është palë pa interes material juridik sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, sepse siç u sqarua edhe me larte, OE ankues ne fund kërkon anulimin ne tërësi te këtij aktiviteti te prokurimit. Prandaj, duke u bazuar ne propozimin e OE ankues i cili kërkon anulimin ne tërësi te këtij aktiviteti te prokurimit, i propozoj panelit shqyrtues, qe ankesa e OE ankues te hudhet poshtë si e palejuar ndërsa vendimi i AK-se te mbetet ne fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohej nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave

të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues nuk lëshohet në konstatimet e pretendimeve ankimore, ku përgjegjësin për përzgjedhjen e OE të rekomanduar për kontratë e mban AK konform nenit 59 dhe 60 të LPP dhe e mbështet arsyeshmërinë e ekspertëve shqyrtues. Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas AK është i eliminuar në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij, eliminimin e tij dhe e atakon OE të rekomanduar për kontratë duke kërkuar që aktiviteti i prokurimit të anulohet. Për këto raste të ngjashme OSHP më dt. 09.02.2023, ka publikuar në ueb faqen e sa një njoftim për OE se si do të trajtohen në rast se nuk respektohen këto parime dhe nuk mund ta kenë pastaj statusin e palës me interes.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Andaj, operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të kësaj ankese ka kërkuar në petitumin e saj që ky aktivitet i prokurimit të anulohet, me këtë veprim OE ankues nuk ka arritur të dëshmoi interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.”

Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me

të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa e OE duhet hedhur si e palejuar. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkruesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të hedhet si e pa lejuar.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së Komuna Rahovec

1x1 OE "Ari med LLC"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.